

20140431263

## L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION SHTETËROR

### Neni 1

Në Ligjin për revizion shtetëror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 145/10 dhe 12/14 ), në nenin 5 shtohet paragrafi i ri (1) si vijon:

“Kryerevizori shtetëror, përkatësisht zëvendësi, zgjidhen nëpërmjet shpalljes publike që publikohet në së paku tre gazeta ditore që botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që e flasin gjuhën zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.”

Në paragrafin (1) që bëhet paragraf (2) shtohen dy pika të reja 4 dhe 5 si vijojnë:

“4) posedon një nga certifikatat ose vërtetimet në vijim të pranuar ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English; Legal)- së paku nivelin B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First)- të dhënë,
- BULATS (BULATS)- së paku 60 pikë,
- APTIS (APTIS)- së paku nivelin B2 (B2);

5) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet;”

Pikat 4 dhe 5 bëhen pika 6 dhe 7.

### Neni 2

Në nenin 9 në pikën 13 fjala “shtetërorë” zëvendësohet me fjalën “administrativë”.

### Neni 3

Neni 13-a ndryshohet si vijon:

“(1) Të punësuarit në Entin Shtetëror për Revizion kanë status të nëpunësve administrativë ose personave ndihmës-teknikë.

(2) Nëpunës administrativë nga paragrafi (1) të këtij neni munden të jenë:

- revizorët e autorizuar shtetërorë, përkatësisht revizorët shtetërorë që kryejnë revizion shtetëror ose

- nëpunësit shtetërorë që kryejnë punë administrative në funksion të kryerjes të kryerjes së mbikëqyrjes të Entit Shtetëror për Revizion të caktuara me këtë ligj.

(3) Për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës për të punësuarit nga paragrafi (2) alineja 1 e këtij neni që nuk janë të rregulluara me këtë ligj dhe me marrëveshje kolektive, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(4) Për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës për të punësuarit nga paragrafi (2) alineja 2 e këtij neni, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë.

(5) Persona ndihmës-teknikë janë të punësuarit në Entin Shtetëror për Revizion që kryejnë punë të mirëmbajtjes, kryerjes së transportit si dhe punë tjera ndihmëse dhe teknike dhe për to zbatohen rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.”

### Neni 4

Neni 13-b ndryshohet si vijon:

“(1) Për revizorët e autorizuar shtetërorë, përkatësisht revizorët shtetërorë përcaktohen nivelet në vijim të vendeve të punës dhe përshkruhen me titujt në vijim:

1) Kategoria B revizorë shtetërorë të autorizuar:

- niveli B1: këshilltarë të Kryerevizorit shtetëror,
- niveli B2: ndihmës i Kryerevizorit shtetëror,
- niveli B3: udhëheqës i revizionit dhe
- niveli B4: ndihmës i udhëheqësit të revizionit dhe

2) Kategoria B revizorë shtetërorë:

- niveli V1: revizor i pavarur,
- niveli V2: revizor i lartë,
- niveli V3: revizor dhe
- niveli V4: revizor i ri.

(2) Provimi për marrjen e titullit të revizorit të autorizuar shtetëror, është provimi i vetëm profesional që paraqet kusht të veçantë për plotësimin e vendit të punës të Kategorisë B. "

#### Neni 5

Në nenin 13-v paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Rrogat e revizorëve shtetërorë të autorizuar, përkatësisht revizorëve shtetërorë përcaktohen në bazë të koeficienteve edhe atë:

- niveli B1: koeficienti 3,40,
- niveli B2: koeficienti 3,30,
- niveli B3: koeficienti 3,10,
- niveli B4: koeficienti 3,00,
- niveli V1: koeficienti 2,90,
- niveli V2: koeficienti 2,70,
- niveli V3: koeficienti 2,50 dhe
- niveli V4: koeficienti 2,00.“

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si vijon:

“(3) Nëpunësit administrativë që nuk kryejnë revizion shtetëror, pranojnë rrogë në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.”

#### Neni 6

Në nenin 16 paragrafi (4) pika 5 fjalët: “shtetërorë dhe publikë” zëvendësohen me fjalët: “administrativë”.

#### Neni 7

Në nenin 30 paragrafi (4) fjala “tre” zëvendësohet me fjalët: “një revizor shtetëror i autorizuar dhe dy revizorë shtetërorë”.

#### Neni 8

Kryerevizori shtetëror përkatësisht zëvendësi të emëruar para ditës së fillimit me zbatim të nenit 1 të këtij ligji do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre deri në skadimin e mandatit për të cilin janë të emëruar.

#### Neni 9

Dispozitat nga neni 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës se huaj që do të fillojnë të zbatohen dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga nenet 3, 4 dhe 5 të këtij ligji që do të fillojnë të zbatohen nga dita e zbatimit të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).